



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TE QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. 01	Nr. 22321
U. _____	Br. _____
Nr. i faq. 5	Data: 12/07
Br. str. _____	Datum: _____
KAMENICË/A 2024	

Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor me Klubet Sportive dhe OJQ-të

Dëgjimi me qytetarë është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarë për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Ëebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimet:

UEBFAQE:

FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=884311693731164&set=pcb.884319097063757>

Me 27.06.2024 dëgjimi publik është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës “Isa Kastrati” duke filluar nga ora 11:07.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Drejtori për Investime Kapitale, Blerim Murina, Drejtori për Kultur, Rini dhe Sport, Behar Hyseni, Zyrtari Kryesor Financiar, Naser Hashani, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore.

Drejtoresha Ardita Dërmaku ka hapur këtë dëgjim: Kam knaqsin të ndaj me juve detajet kryesore të buxhetit për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë sa i përket investimeve kapitale dhe subvencioneve. Kjo është një mundësi që të merrni pjesë aktivisht në planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve tona të ardhshme. Sygjerimet dhe komentet e juaja kanë një rëndësi shumë të madhe sepse bashkarisht më kërkesat e juaja do ta përfitojmë një draft buxhet për vitin e ardhshëm. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro, krashasuar me vitin 2024 kemi një rritje prej 5.2%, ku pjesa e dedikuar për investimeve kapitale arrin shumë më 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumë më 885,000.00 euro. Nga ju

pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres qe përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishmë për Klubet Sportive dhe OJQ-të.

Zëdhënsja e Komunës Lidiona Marova ka prezantuar punët që janë bërë vitin e kaluar dhe janë duke u bërë: Në sektorin e rinis dhe të shoqërisë civile janë bërë subvencionimi i klubeve sportive dhe i organizatave civile, projektet e tjera janë edhe stadioni i atletikes në Roganë, stadioni i klubit futbollistik KF.KIKA, turniri Rogana- fusha në Roganë, interesimi do të vazhdoj që të ketë bashkëpunime me klubet sportive si dhe me organizatat e shoqëris civile.

Kërkesat ishin të ndryshme si:

Qmail Fetiu, Klubi i Shahut Daradana: Ne si klub kemi bërë jashtëzakonisht kërkesa, dhe ne nuk jemi tu marrë përgjigje dhe as mbeshtetje, nuk i ipet prioritet këti sporti. Nuk jemi të knaqur me mjetet që po ndahen në subvencionimin e klubeve. Duhe të miren parasysh kërkesat që ne si klub i bëjmë, sidomos kërkesa e hapsirës ku duhet të mbahen garat. Ne nuk mund të zhvillojme asnjë aktivitet pa hapsirë.

Granit Dermaku, Klubi Besa: edhe unë i ndaj të njejtat shqetsime, kemi kohë që kërkojm një zhveshtore. Shum vite më herët ne kemi kërkuar këtë zhveshtore. Kemi kerkuar 10.000 euro për këtë zhveshtore, mirëpo ka ra në vesh të shurdhër, subvencionimet nuk shpërndahen në mënyrë të barabart. Kërkoj drejtësi në subvencione si dhe në projekte.

Drejtoresha Artitë: ne do ti marim të gjitha prioritete dhe do ti vendosim në listen e projekteve për vitin e ardhshëm.

Shehat Rrudhani, Kryetari i komisionit për ndarjen e subvencioneve përgjigjet: ne kemi pranuar ankes nga klubi Besa dhe ju ka kthyer përgjigja nga komisioni i ankesave.

Nexhmedin Isufi Klubi i Karates Arbëria: klubi i karates Arbëria është klubi më i vjetër në komunën tonë, ne e kemi mbajtur gjallë në nivel republikan, ne si klub nuk jemi të knaqur sa i përket subvencioneve, ne atë komision dua të di se qfar kriteresh kanë për ndarjen e subvencioneve?, kam bërë edhe ankesë, mirë po nuk kanë ndërmarr asnjë hap, ndarja e subvencioneve nuk është në mënyrë të barabart dhe të drejt. Kërkoj që ndarja e subvencioneve të jetë transparente, nuk ka të drejt që një përfaqësues i një komisioni të jetë edhe përfaqësues i një klubi, nuk ka ndarje të barabart të subvencioneve. Termimi i palestres nuk bëhet në rregull, se nuk jam i knaqur.

Drejtori për Kultur, Rini dhe Sport, Behar Hyseni: në vitin e kaluar në thirrje publike klubit të juaj ju ka nda 1000 euro, mirëpo kur keni pasur kërkes të veqant jashta thirrjes për me shku në një garë ndërkombëtare në Athinë, ju kemi mbështet edhe me 1000 euro tjera, kshtu që ju kur të keni gara ndërkombëtare mundeni me ba kërkes jashta thirrjes publike për subvencionimin e klubeve sportive, sikur vitin e kaluar që ju kemi mbështët ju mbështesum edhe këtë vitë, mirëpo ju po bëni ankes pa e bërë kërkesen.

Shehati përgjigjet: Kriteret janë transparente, kriteret janë të përcaktuara me rregullore dhe vinë nga ministria, nuk i kemi caktu ne ato janë të përcaktuara me rregullore dhe në bazë të asaj ne edhe punojmë.

Afrim Morina, klubi i Badmitonit Arbëria: sportet dallojnë specifikisht secili, nuk janë të njëjta. Por nuk duhet të anashkalohen. Kërkesa nga klubi është për furnizim me rekuizita sportive për këtë klub, raketat duhet të jenë origjinale, mungesa e sallës është projekt me madhor dhe ju kisha lutur që të i adresoni më furnizim për buxhet nga ndërkombëtarët. Rritja e subvencioneve nuk shkon askund pos të këta fmi ton që janë në klube.

Rasim Rahimi, klubi i futbollit Dardana: klubi dardana e ka ekipen senior, edhe grupmoshat nga 8 deri në 17 vjeq, subvencioni që është nda është një ndihmë e madhe për neve, sepse na lehtëson punën në fuqizimin e klubit, regjistrimit të lojtarëve, ushqimit dhe rrugës. Kërkesa jonë është rekuizita sportive dhe ndrrësat sportive dhe nëse investohet në stadion kam kërkesa që të marrim pjesë në hartimin e projektit.

Lavdim Klaiqi, OJQ Proactive: I ndëgjova me shumë vëmendje kolegët nga OJQ, a do të ketë rritje të fondeve për OJQt posaqërisht për klubet sportive dhe OJQ-ve për vitin e ardhshëm? A keni përkrahje nga komunat tjera? Përkrahja e OJQve nga komunat tjera të ulët dhe të rritet në komunën tonë për OJQt dhe klubet sportive, qasja e OJQv dhe klubet tona janë zero në komunat e tjera. Fondet që janë nda për OJQt jashtë komunës tonë të ndërprehen dhe të ndahen vetëm për klubet tona dhe shoqatat tona.

Drejtoresha Arditë: sa i përket shumës së përgjithshme rritja është nga 680 mijë në 885 mijë për kategorin e subvencioneve.

Drejtori Behar: në këtë vitë i kemi rritë dikun për 10 mijë euro për klubet sportive dhe OJQ-t, besoj që edhe vitin tjetër do të ketë rritje,

Albulent Spahiu, Ansambli Zëri i Kamenicës: ne marrim pjesë në festivale të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit, kemi pas mbështetje edhe nga komuna por nuk kanë qenë edhe mjaftueshme për këtë vitë kemi marrë më pak subvencione se vitin e kaluar. Për vitin 2025 ne kemi nevojë për mbështetje në veshje për grupmoshat 9 deri në 10 vjet, kemi nevojë për zyrë një hapsirë për takime, ruajtjen e instrumenteve dhe veshjeve të ansamblit, organizimi i festivalit për këngë dhe valle, të jetë zgjerimi i grupeve më të mëdha ngritja e kapaciteteve të festivalit. Mbështetje financiare për festivalet në vendet jashtë Kosovës.

Alban Maliqi : të gjitha OJQ duhet të luftojnë në ngritje të kapaciteteve të tyre, edhe ne si OJQ luftojmë me organizatat ndërkombëtare, duhet të fillojnë të shkruajnë projektet, duhet të dalin jashtë komunës që të marrin fondet, unë pas shumë nevojë. Pse mos me i kërkuar komunës tendere me kërkesat qoftë rekuizitat sportive ose qka do tjetër, secili klub veq e veq me kërkesat e tyre, dhe komuna me dal me tendere dhe me i ble këto paisjet. Subvencionimi, secili klub e din sa pare i duhen brenda vitit, nëse ka komuna jua jep, mirëpo edhe komuna nuk ka mjaftueshëm është e limituar, atë pjesë që nuk ta mbulon komuna duhet të luftoni ju vetë.

Agim Abdullahu përgjegjës për Sport: I ndëgjova ankesat, i mbështes disa mirëpo duhet ta din se nuk bazohen në ligje sportive për regjistrim të klubeve, sa i përket subvencioneve asnjë anëtar i

komisionit nuk ka të kryer ndonjë trajnim ose nuk ka qenë në federatën përkatëse dhe të shohet se qfarë ka hargjime në klubet sportive, infrastruktura sportive punohet pa pjesëmarrjen e profesionistëve në sport, e cila bëhet pa marrjen e mendimit të profesionistëve. Rrethoja e stadionit të cilën e kemi problem me pronarin që është afër stadionit të qytetit.


	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Qmail Fetiu, Klubi i Shahut Daradana:	Rritja e shifrës në Subvencione për klubet sportive dhe OJQ-t, Hapsirë e posaqme për klubin e Shahut.	Me telefon
2.	Granit Dërmaku, Klubi Besa:	Zhveshtore të klubit, Shpërndarja e barabart e subvencioneve.	Me telefon
3.	Nexhmedin Isufi, Klubi i Karates Arbëria:	Transparencë në kritere për subvencione, Termin të veçant në palestër.	Me telefon
4.	Afrim Morina, Klubi i Badmintonit Arbëria	Rekuizita sportive, Sallë e sportit për badminton, Rritje të subvencioneve.	Me telefon
5.	Rasim Rahimi, Klubi i futbollit Dardana:	Rekuizita sportive, Ndrresa sportive, Pjesëmarrje në hartimin e projekteve.	Me telefon
6.	Lavdim Klaiqi, OJQ Proactive	Rritja e fondeve të OJQve dhe Klubeve sportive, Nërprerja e fondeve për OJQ jashtë komunës.	Me telefon
7.	Albulent Spahiu, Ansambli Zëri i Kamenicës	Mbështetje në veshje, Zyrë-hapsirë të veçant për Veshjet, instrumentet, takime etj., Ngritja e kapaciteteve të festivalit, Mbështetje financiare jashtë vendit.	Me telefon
8.	Alban Maliqi	Hapjen e tendereve, për blerjen e paisjeve sportive.	Me telefon
9.	Agim Abdullahu, përgjegjës për Sport	Rregullimi i rrethojës në stadionin e qytetit.	Me telefon

Të gjitha këto kërkesa të banorëve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 12:15 .

Procesmbajtëse:

Samirë Krasniqi

_____